Kronikë

Me maska e kapele, 3 adoleshentë në Tiranë thyejnë xhamin e një biznesi dhe e grabisin! Në pranga 2 prej tyre! Qarkullonin me armë (VIDEO)

Policia e Tiranës ka vënë në pranga 2 adoleshentë, 16 vjeçar, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim pasi, dyshohet se kanë vjedhur në dy dyqane në Tiranë si dhe qarkullonin të armatosur

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
25 Shtator, 10:06 | **Përditësimi: 25 Shtator, 10:18**

Share

Policia e Tiranës ka vënë në pranga 2 adoleshentë, 16 vjeçar, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim pasi, dyshohet se kanë vjedhur në dy dyqane në Tiranë si dhe qarkullonin të armatosur.Në një prej rasteve kur adoleshentët kanë vjedhur bizneset, shihen me maska dhe me kapele, ndërsa thyejnë xhamin e dyqanit me gurë, për tu futur në të dhe për të vjedhur.

Nga hetimet ka rezultuar se këta shtetas, ditët e fundit, kanë vjedhur një laptop dhe katër celularë, në dy dyqane me pajisje elektronike. Policia thotë se pas informacioneve se autorët e dyshuar po qarkullonin të armatosur, me një automjet, në aksin rrugor Shkozë-TEG, kanë organizuar punën për kapjen e tyre.

[Sh].com

LEXO EDHE:
Kreu manovra të rrezikshme në rrugë, ndëshkohet me gjobë 40 mijë lekë shoferi i 'Porsche' në Tiranë

Gjatë ndjekjes, drejtuesi i automjetit është larguar dhe ka hedhur një armë zjarri pistoletë, nga dritarja e automjetit. Në tentativë për t'u larguar, drejtuesi i automjetit ka humbur kontrollin dhe e ka përplasur automjetin me trafikndarësen. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan automjeti, një armë zjarri pistoletë, një laptop dhe 11 celularë.

Vijon puna për dokumentimin e vjedhjeve të tjera që janë kryer nga këta shtetas.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: vjedhje policia e tiranes Tirane

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Vritet polici në Kosovë, a po reagojnë si duhet ndërkombëtarët ndaj Serbisë

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

EMRI/ Kreu pesë vjedhje nga korriku në shtator, arrestohet 30-vjeçari në Berat! Ishte shpallur në kërkim nga policia
25 Shtator, 10:36

Premiera e filmit "Kaymak" e regjisorit Milcho Manchevski, Veliaj: Tirana gumëzhin nga turistët dhe aktivitetet e kulturës
24 Shtator, 19:18

Report Tv sjell rastin e vogëlushes me sëmundje të rëndë! E ëma: Ishim në Itali, u kthyem se s'kishim lekë ta kuronim atje, na ndihmoni
Ledina Jakimi
24 Shtator, 17:27

Tiranë/ Polici i Vlorës nuk i bindet urdhrit për kontroll, dhunon bashkë me dy miqtë efektivin e Shqiponjave! AMP nis hetimet
Sokol Dema
24 Shtator, 14:43

Basha nga Zall-Herri: Ndëshkimi i korrupsionit në nivelet e larta, fillimi i ndryshimit të vërtetë që presin shqiptarët
24 Shtator, 14:32

Mbyll siparin Edicioni XXI i 'Tirana International Film Festival', Veliaj: Traditë e Tiranës
24 Shtator, 11:22

Shfrytëzonte vajza për prostitucion, arrestohet 19-vjeçari në Tiranë! Gjente klientët në rrjete sociale dhe i orientonte nëpër hotele
24 Shtator, 10:11

Zjarri masiv në fabrikën e bojërave në Maminas, anulohet dasma në resortin ngjitur! Ikën nusja e dhëndri, evakuohen dasmorët
23 Shtator, 23:36

VIDEO/ Zjarr i madh në fabrikën e bojërave Deutsch Color në autostradën Tiranë - Durrës! Pas 5 orësh izolohen flakët
23 Shtator, 22:36

Tiranë/ U vuri shkrepësen mbeturinave në Kashar, zjarri djeg sipërfaqe me ullinj dhe bimësi, arrestohet 55-vjeçari
23 Shtator, 22:19

Skulptura e Adi Dules në sheshin "Bukureshti", Veliaj: Sa bukur të shohësh artin të lulëzojë
23 Shtator, 18:52

58 vite me shtiza dhe grep me dorë, 73 vjeçarja end mbulesa, çentro e këmisha: S'e lë dot prej dëshirës së madhe! Panairet mundësi për shitje
Ledina Jakimi
23 Shtator, 18:09

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje